



## PROCESVERBALI

Nga mbledhja e tetë e rregullt e Kuvendit Komunal të Graçanicës

E mbajtur më datën 26.12.2023 në sallën e Kuvendit Komunal të Graçanicës dhe filloi me punë në ora 10:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se sipas evidencës së zyrtarit të Kuvendit, në mbledhje janë të pranishëm 17 nga 19 asamblistë dhe sa ka kuorum, ndërsa 2 asamblistë mungojnë: Ljubisha Karaxhiq dhe Granit Gashi.

Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit e KFOR-it, kryetarja e komunës së Graçanicës, shefja e Kabinetit, drejtorët e drejtorive komunale të: Administratës dhe Personelit; të Zhvillimit Ekonomik dhe Integriteteve Evropiane; të Urbanizmit, Planifikimit dhe Mbrojtjes së Mjedisit; të Kadastrës; të Rinisë dhe Sportit; të Bujqësisë dhe Pylltarisë; të Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente; të Inspektionit; pastaj drejtori i NPK "Ekologjia", drejtoresha e OTG-së, zyrtari i Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Shërbimi i Përkthimit, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit është mbajtur mbledhja e tetë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e dha mendimin pozitiv për rendin e ditës të caktuar për mbledhjen e sotme të Kuvendit me një plotësim "Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim për vitin 2024, me propozim të kryetares së komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e propozuar të ditës me plotësimin në fjalë.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve "Pro", miratoi rendin e mëposhtëm të ditës:**

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 20.11.2023.
2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Komunës së Graçanicës për periudhën prej 31.05.2023 deri më 30.11.2023, me propozim të kryetares së komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit për periudhën prej 01.12.2021 deri më 01/12/2022, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq.

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim të Rregullores nr.01/2023/KG për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.02/2021/KG (nr.1551/21 e datës 07.04.2021) për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Graçanicës, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2024, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

6. Informacione për punën e institucioneve shëndetësore në komunë, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milliq.

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim për vitin 2024, me propozim të kryetares së komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

8. Të ndryshme.

**Në mbledhje është i pranishëm asamblisti Granit Gashi, të pranishëm janë gjithsej 18 asamblistë dhe ka kuorum.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e katërt e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 20.11.2023.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 18 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.**

Asamblistja Snezhana Jovanoviq, para partisë “SRPSKA”, ka kërkuar që të testohet niveli i manganit në liqen, pasi që këtë kërkesë e ka paraqitur edhe në mbledhjen e kaluar të Kuvendit.

**Në mbledhje është i pranishëm asamblisti Ljubisha Karaxhiq, të pranishëm janë gjithsej 19 asamblistë dhe ka kuorum.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Komunës së Graçanicës për periudhën prej 31.05.2023 deri më 30.11.2023, me propozim të kryetares së komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Kryetarja Shubariq tha se viti pas nesh ka qenë i mbushur me sfida në të gjitha sferat e punës, por edhe përkundër vështirësive janë arritur rezultatet e mira. “Ne kemi bërë përpjekje të mëdha për t’i përfunduar të gjitha projektet e planifikuara infrastrukturore. Ne i kushtuam të njëjtën rëndësi çdo familjeje, individi, çdo fëmije dhe çdo vendi në komunë, institucioni, organizatëve sportive dhe kulturore, ndihmuam dhe investuam në bazë të nevojave dhe prioriteteve”. Kryetarja Shubariq theksoi se fokusi i Komunës së Graçanicës këtë vit ka qenë përmirësimi dhe zhvillimi i tre sektorëve të rëndësishëm - arsimit dhe kulturës, shëndetësisë dhe mirëqenies sociale, infrastrukturës dhe sistemeve komunale. “Drejtoria Komunale e Arsimit, përveç mbështetjes

financiare, ka ofruar mbështetje logjistike për të gjitha institucionet arsimore, shtëpitë e kulturës dhe klubet sportive në territorin e komunës sonë. Ndërtuam objekte të reja, rinovuam dhe rikonstruam objekte ekzistuese dhe kryem punime të tjera infrastrukturore që modernizuan dhe zgjeruan hapësirën për realizimin e procesit mësimor në institucionet parashkollore, shkollat fillore dhe të mesme. Raporti që keni para jush përmban një listë të të gjitha investimeve në arsim gjatë këtij viti. Do t'i veçoj vetëm disa, blerjen e inventarit për shkollat, rregullimin e rrethojave dhe oborreve të shkollave, rregullimin dhe ndërtimin e parqeve për fëmijë, ndërtimin e sallës së sallës së qendrës shumëqëllimore në Livagjë, rinovimin dhe shtimin e terreneve sportive. Dhe ajo që është shumë e rëndësishme është se ne kemi mbështetur të gjitha ngjarjet kulturore dhe sportive”, tha Shubariq.

Edhe këtë vit nuk kanë munguar investimet në shëndetësi dhe përkujdesje sociale, gjegjësisht përkujdesje dhe mbështetje sociale për kategoritë vulnerabël të qytetarëve.

“Vetëm në Qendrën diagnostike në Graçanicë në periudhën që mbulon raporti janë ofruar mbi 30 mijë shërbime laboratorike dhe mbi 6 mijë shërbime në repartin e fiziatrisë në Graçanicë dhe mbi 5 mijë në Gushtericën e Poshtme. I kemi modernizuar pothuajse të gjitha qendrat shëndetësore parësore si dhe Qendrën spitalore klinike me pajisje të reja mjekësore. Këtu dua të veçoj blerjen e lëndëve shpenzuese për shëndetësinë primare dhe sekondare në vlerë prej 30.000 euro në kohën kur sistemi ynë shëndetësor po përballej me mungesën e barnave dhe materialeve konsumuese për shkak të pamundësisë së furnizimit të tyre nga Republika e Serbisë. Nuk mund të mos përmend edhe donacionin për Qendrën spitalore klinike në vlerë mbi 100 mijë euro në formën e dy aparateve për anesteziën”.

Duke folur për projektet e infrastrukturës, kryetarja Shubariq theksoi se vitin e kaluar janë asfaltuar mbi 11 km rrugë dhe rrugicë.

“Kemi filluar ndërtimin e Qendrës edukative dhe rekreative, pastaj kapelën me objekt ndihmës, jemi duke përfunduar fazën e dytë të objektit banesor në Llapllasellë, kemi nënshkruar një memorandum për ndërtimin e një pushimores afër shatërvanit, përfunduam objektin shumëfunksional në Livagjë. Dhe në periudhën e ardhshme, kur të lejojnë kushtet atmosferike, do ta rindërtojmë rrugën kryesore në Graçanicë”.

Kryetarja Shubariq vlerësoi edhe Drejtorinë Komunale të Inspektionit, e cila, siç tha ajo, përkundër kritikave të shpeshta, me sukses ka punuar në rregullimin e tregut ekonomik, kontrollin inspektues të subjekteve ekonomike, punimet ndërtimore dhe parandalimin e keqpërdorimit të tokës bujqësore.

“Punën e palodhshme në terren në të gjitha situatat e rregullta dhe emergjente e kanë demonstruar këtë vit punëtorët dhe drejtuesit e Drejtorisë së Shërbimeve Publike. Drejtoria e Bujqësisë punoi pa u lodhur për të ofruar jo vetëm asistencë për fermerët, por edhe shërbime këshillimore dhe administrative. Drejtoria e Kadastrës ka pranuar 3612 kërkesa, shumica e lëndëve janë proceduar

dhe pjesa tjetër janë në fazën e zbatimit. Drejtorja e Rinisë dhe Sportit, edhe pse pa buxhetin e vet, ka përkrahur klube dhe organizata të shumta sportive”, tha kryetarja Shubariq dhe shtoi se qeverisja lokale i është përkushtuar veçanërisht fuqizimit ekonomik të grave dhe të rinjve.

Kryetarja e komunës së Graçanicës, prof.dr. Ljiljana Shubariq, tha se shpreson që komuna do të arrijë të njëjtat rezultate të mira edhe në vitin e ardhshëm 2024 dhe më pas i uroi të gjithëve për festat e ardhshme të Vitit të Ri dhe Krishtlindjeve.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë “SRPSKA”, tha se në Graçanicë nuk i kanë kushtet elementare themelore për jetë, ajri dhe uji janë të ndotur. Ajo pyeti se çfarë kishte bërë Komuna e Graçanicës lidhur me këtë dhe a ka siguruar një cisternë me ujë të pijshëm, derisa ishte në fuqi ndalimi për përdorimin e ujit të rubinetit.

Kryetarja u përgjigj se komuna ka siguruar një cisternë me ujë të pijshëm (në Padallishtë), gjatë ndalimit të përdorimit të ujit nga rubineti. Në lidhje me ndotjen e ajrit, kryetarja tha se me këtë rast kanë biseduar me drejtorin e “Trepçës” për deponinë e mbeturinave dhe kemi marrë një premtim që në vitin 2024 do të fillohet me procesin e zgjidhjes së këtij problemi.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë “SRPSKA”, tha se në raportin në Sektorit të Prokurimit thuhet se për mbjelljen e luleve dhe pemëve zbukuruese janë ndarë 90.000 euro dhe për pastrimin dhe larjen e rrugëve 1.600.000 euro dhe se në këtë periudhë janë shpenzuar 118.000 euro për rregullimin e rrugës “Car Lazar” në Graçanicë në periudhën prej 03.10. deri më 26.10.

Kryetarja u përgjigj se tenderi për rregullim ka kaluar, por nuk janë kryer punimet për shkak të kushteve të këqija atmosferike dhe plani është që ajo rrugë të përfundohet në pranverë.

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente, Vlladica Trajkoviq, u përgjigj se vetëm emri i projektit është “Pastrimi dhe larja e rrugëve” por me atë projekt përfshihet edhe pastrimi i shtretërve të lumenjve dhe kanaleve të shiut gjatë vërshimeve, mirëmbajtja dimërore e rrugëve, ndërsa shuma është parashikuar për tre vjet.

Asamblisti Nebojsa Markoviq, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse komuna ka plane për të ndërtuar një bypass rreth Graçanicës, në mënyrë që të lehtësohet rruga kryesore, dhe kështu rruga kryesore të bëhet një zonë për këmbësorë.

Kryetarja u përgjigj se një nga prioritetet është ndërtimi i një bypass-i, projekti ka qenë prej kohësh, por asnjëherë nuk është përcjellë në ministri. Ne e kemi përcjellë atë projekt në ministri dhe e kemi diskutuar me të gjitha institucionet relevante dhe komunitetet ndërkombëtare. Ky projekt është prioritet për shkak të bllokimit të trafikut, prishjes së statikës së manastirit të Graçanicës, ndërsa për realizimin e projektit në fjalë nevojiten mjetet e mëdha financiare.

Asambleti Vlladica Gjurçiq, para partisë "SRPSKA", tha se njerëzr që punojnë në arsim e dinë që shkollat tona po boshatisen gjithnjë e më shumë dhe mendon se zgjidhja e atij problemi duhet të jetë prioritet.

Kryetarja u përgjigj se ata janë të njohur me atë problem dhe fakti që ne kemi thënë në raport që shkollat tona janë plot me nxënës është dëshira jonë dhe shkollat kanë një numër të mjaftueshëm nxënësish, por ne do të punojmë për këtë dhe do të bëjmë gjithçka që është në fuqinë tonë.

Kryesuesi i Kuvendit shtoi se është e vërtetë që numri i nxënësve në Shkollën Teknike është në rënie, por në Shkollën e Mjekësisë ka shumë nxënës.

Asambleti Millosh Todoroviq, para partisë "SRPSKA", tha se rruga "Dositejeva" (nga furra e bukës deri te pompa) është shumë e ngarkuar me trafik dhe nuk është bërë asgjë për rregullimin e saj.

Kryetarja u përgjigj se shpronësimi i tokës në atë pjesë është i rregulluar dhe në periudhën e ardhshme pritet zgjerimi dhe shenjimi i asaj rruge, sepse së shpejti do të vihet në funksion një çerdhe dhe në ndërtesat do të vendosen banorët.

Asambleti Ljubisha Karaxhiq, para partisë "SRPSKA", rikujtoi se Llapllasella është qendër gjeografike e komunës së Graçanicës dhe se është e ngarkuar edhe me trafik dhe se duhet pasur parasysh infrastrukturën rrugore. Në vitin e ardhshëm projektet e prezantuara nga banorët e Llapllasellës, Preocit dhe Çagllavicës në prezantimin e buxhetit duhet të realizohen, nëse jo të gjitha, atëherë së paku projektet kryesore dhe prioritare.

Asambletja Sonja Odallovic, para partisë "SRPSKA", pyeti a është planifikuar rindërtimi i rrugës "Tomislav Sekulliq" në Padallishtë vitin e ardhshëm.

Kryetarja u përgjigj se rinovimi i asaj rruge është planifikuar për vitin e ardhshëm.

Asambletja Sonja Odallovic para partisë "SRPSKA", sugjeroi që në atë rrugë të vendoset tabela e kufirit të shpejtësisë, si dhe një polic i shtrirë ose një pasqyrë për shikueshmëri më të mirë.

Drejtoresha e Drejtorisë së Urbanizmit, Alleksandra Gjekiç, u përgjigj se në atë pjesë ka një ngjitje të madhe dhe për shkak të kushteve të motit gjatë dimrit është e pamundur të vendoset një "polic i shtrirë" atje.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 17 asambletëve "Pro", 1 votë "Kundër" të Granit Gashit dhe 1 votë "Abstenim" të Sllagjanës Rashic, e miratoi pikën e dytë të rendit të ditës.

Në mbledhje mungon asambleti Granit Gashi, të pranishëm janë 18 asambletë dhe ka pasur kuorum.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i raportit të punës së Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit për periudhën prej 01.12.2021 deri më 01/12/2022, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq.

Drejtori i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq, theksoi se drejtoria nuk e ka buxhetin e vetë, por mbi të gjitha, falë mirëkuptimit të kryetares Shubariq, ka arritur t'i zbatojë dhe t'i ndihmojë organizatat dhe shoqatat e ndryshme sportive. "Kemi miratuar 60 kërkesa për transportin e sportistëve në territorin e Kosovës dhe rajonit, kemi rikonstruktuar gjashtë terrene sportive shumëfunktionale dhe këtë vit e kemi rregulluar edhe kompleksin sportiv "Dragan Xhajiq". Ne përkrahëm dhjetë turne përkujtimore dhe ndërkombëtare në formën e pajisjeve sportive dhe rekuizitave dhe organizuam tre turne humanitare, në të cilat morën pjesë ekipet serbe lokale dhe qendrore. Subvencione kanë marrë 17 organizata joqeveritare", tha Cvejiq. Dejtoria për Rini dhe Sport e ka kryer pagesën vjetore në vlerë prej 1400 euro për dhënien me qira të sallës së mbyllur në kompleksin sportiv "Dragan Xhajiq", ndërsa salla sportive në Llapllasellë dhe stadiumi në Graçanicë nuk janë dhënë me qira. Drejtoria për Rini dhe Sport ka vetëm një të punësuar, ndërsa 26 punëtorë janë të angazhuar nga Drejtoria e Arsimit dhe NPK "Ekologjia".

Ai theksoi se sukcesi më i madh ishte ardhja e Institutit Krahinor për Sport dhe Mjekësi Sportive nga Novi Sadi me qëllim të testimit dhe ekzaminimit të mbi 150 sportistëve të moshës 10 deri në 18 vjeç me shpenzimet e vetë Institutit.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë "SRPSKA", pyeti se si zgjidhen fëmijët që do të shkojnë në kamp.

Drejtori i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq, u përgjigj se ata ishin sportistë që u testuan dhe u caktuan trajnerët e shkollës: së futbollit, karates dhe volejbollit, të cilët vendosnin se cilët fëmijë do të shkonin në kamp.

Asamblisti Nebojsa Markoviq, para partisë "SRPSKA", e vlerësoi raportin për punën e Drejtorisë për Rini dhe Sport, si dhe vetë drejtorin, i cili arriti të sigurojë mjete për rindërtimin e terreneve sportive, për ndarjen e pajisjeve dhe rekuizitave sportive, si dhe ka mbështetur turnetë sportive, edhe pse drejtoria nuk e ka buxhetin e vet. Ai sugjeroi që në raportin e ardhshëm të listohen organizatat joqeveritare që kanë marrë subvencione.

Asamblistja Sllagjana Rashiq, para partisë "SRPSKA", pyeti nëse është bërë ndonjë gjë në lidhje me ngrohjen e sallës së sportit në Llapllasellë.

Drejtori i Drejtorisë së Rinisë dhe Sportit, Dushan Cvejiq, u përgjigj se salla u vu në funksionim në vitin 2016 dhe ajo kurrë nuk ka pasur ngrohje. Problemi është se ngrohja është me naftë dhe harxhon 120 litra në orë, gjë që kap shumën prej 150 euro dhe meqë sezoni i ngrohjes

zgjat 6 muaj do të na duheshin 400 mijë euro dhe salla nuk është fitimprurëse dhe nuk jepet me qira.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 17 asamblistëve “Pro” dhe 1 votë “Abstenim” të Sllagjanës Rashiq, e miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim të Rregullores nr.01/2023/KG për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr.02/2021/KG (nr.1551/21 e datës 07.04.2021) për menaxhimin e mbeturinave në komunën e Graçanicës, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi shpjegoi se ministria kompetente ka kërkuar që Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Graçanicës të ndryshohet në preambulë, si dhe në nenin 9 paragrafi 2.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 17 asamblistëve “Pro” dhe 1 votë “Abstenim” të Sllagjanës Rashiq, e miratoi pikën e katërt të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës:

5. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2024, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi shpjegoi se grupi punues në bashkëpunim me drejtorët e drejtorive e ka hartuar Planin e punës së Kuvendit për vitin 2024.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 18 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e pestë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e gjashtë të rendit të ditës:

6. Informacione për punën e institucioneve shëndetësore në komunë, me propozim të drejtoreshës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Zorica Milliq.

Zyrtari i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, Sllobodan Kostiq, tha se Drejtorja e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale është një drejtori operative dhe se kryesisht merret me detyra administrative dhe logjistike, si dhe me ndihmën që ata ofrojnë për institucionet shëndetësore që punojnë në territorin e komunës së Graçanicës. Qendrat shëndetësore dhe QKS-ja nuk kanë asnjë detyrim të raportojnë në Drejtorinë e Shëndetësisë. Institucionet shëndetësore të themeluara nga Komuna e Graçanicës janë Qendra diagnostike në Graçanicë dhe Ambulanca në Livagjë dhe Suhadoll. Informacioni tregon tabelat për numrin e përdoruesve dhe numrin e shërbimeve në kujdesin shëndetësor dhe social, si dhe donacionet për institucionet shëndetësore. Në bazë të kërkesave të institucioneve shëndetësore, për vitin e ardhshëm është planifikuar blerja e një automjeti mjekësor, pajisje për dializë dhe një shtyllë për endoskopi.

Asamblisti Zoran Danilloviq, para parties “SRPSKA”, pyeti nëse dihet se për cilin institucion shëndetësor planifikohet të blihet një automjet sanitar.

Zyrtari Slllobodan Kostiq u përgjigj se kërkesa nga Shërbimi i Emergjencave në Llapllasellë dhe shtoi se ata kanë më shumë nevojë për atë automjet.

Asamblistja Sonja Odallovic, para parties "SRPSKA", tha se Qendra diagnostike ka ordinancë gjinekologjike, dermatovenerologjike, etj. por nuk është paraqitur numri i përdoruesve dhe shërbimeve në këtë tabelë.

Zyrtari Slllobodan Kostiq u përgjigj se tabela përmban listën e të gjitha kabineteve të pajisura, por vit pas viti kemi mbetur pa shërbime për pacientët. Ai shtoi se se i ndjeri dr. Millovanovic ka punuar në Kabinetin e mjeksisë interne dhe pas kësaj asnjë mjek nuk ka pranuar të punojë në atë kabinet.

Asamblisti Millosh Todorovic, para parties "SRPSKA", tha se kanë kërkuar nga drejtori i mëparshëm që në raportin vjetor të Drejtorisë së Shëndetësisë ta përfshijë edhe raportin financiar të detajuar për mjetet e shpenzuara, në mënyrë që ai t'ia përcjellë drejtoreshës.

Kryesuesi pyeti se a marrin pagë mjekët që nuk vijnë për të punuar në kabinetet në Qendrën diagnostike.

Zyrtari Slllobodan Kostiq u përgjigj se mjekët marrin pagë. Ata mjekë duhet të angazhohen në përputhje me numrin e orëve të punës sipas kontratës së punës dhe për këtë kemi pasur një sugjerim nga Inspektorati shëndetësor.

Kryesuesi tha se do të kërkojë nga Drejtorja e Shëndetësisë që Kuvendit t'i sigurojë listën e mjekëve që marrin paga nga Komuna e Graçanicës, por nuk vijnë të punojnë në Qendrën diagnostike.

Asamblistja Sonja Odallovic, para parties "SRPSKA", tha se puna e Kabinetit për dermatovenerologji dhe e Kabinetit të endokrinologjisë do ta rriste buxhetin financiarisht, duke pasur parasysh se shpeshherë në qendrën shëndetësore dhe spitalin nuk ka mjekë endokrinologë.

Zyrtari Slllobodan Kostiq u përgjigj se kanë një listë çmimesh për shërbimet dermatologjike që i kanë dhënë dhe e kanë tarifuar për një kohë kur ka punuar lazeri, ndërsa ekzaminimet e specializuara janë falas.

Asamblistja Slllagjana Rashic, para parties "SRPSKA", sugjeroi që pajisjet që nuk funksionojnë të servisohen në mënyrë që komuna të ketë të ardhura nga kjo.

Zyrtari Slllobodan Kostiq u përgjigj se edhe ky është problem, sepse gjithçka që duhet të zbatohet duhet të futet në planin e prokurimit për vitin e ardhshëm. Ne kurrë nuk kemi pasur shërbime të pajisjeve mjekësore dhe ato janë servisuar vetëm nga prodhuesit dhe furnitorët, ndërkohë që kanë një garanci për një ose dy vjet. Pajisjet mjekësore janë në pronësi të Komunës



së Graçanicës, të cilat u jepen në përdorim institucioneve shëndetësore dhe kur ndodhin keqfunksionime, vetë institucionet e financojnë riparimin e tyre.

Asambleti Zoran Danilloviq, para partisë "SRPSKA", tha se ka informacione se menaxherit të Shtëpisë së të rinjve i skadon kontrata në fund të dhjetorit dhe se duhet të shpallet konkursi.

Zyrtari Sllobodan Kostiq u përgjigj se nuk e ka atë informacion dhe se çështjen do t'ia përcjell drejtoreshës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për miratimin e listës së pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim për vitin 2024, me propozim të kryetares së komunës së Graçanicës, Ljiljana Shubariq.

Kryesuesi paraqiti problemin që gjithçka që gërmohet nga Kompania rajonale e ujësjellësit duhet të kthehet në gjendjen e mëparshme. Ai shtroi pyetjen se pse komuna nuk arrin marrëveshje me Ujësjellësin apo nëse ata nuk do ta respektojnë atë marrëveshje, atëherë ata duhet ta padisin kompaninë.

Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Publike dhe Situatave Emergjente, Vlladica Trajkoviq, është përgjigjur se për këtë ka insistuar në disa takime dhe është ofruar një version i marrëveshjes mes komunës dhe Kompanisë rajonale të ujësjellësit, por për shkak të ndërrimit të drejtorit dhe bordit të drejtorëve në këtë kompani ende nuk është nënshkruar marrëveshja.

Drejtori Trajkoviq e ka shpjeguar propozimin, duke thënë se Komuna e Graçanicës ka pronë të paluajtshme në territorin e saj e cila në bazë të nevojave dhe kërkesave mund të shfrytëzohet, por në bazë të ligjit është e nevojshme të publikohet lista e pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim, në mënyrë që në vitin e ardhshëm të kryhet procedura përmes thirrjeve publike.

Lista e pronave të paluajtshme të komunës të dhëna në shfrytëzim përbëhet nga pronat e mëposhtme:

Nr.r.	Të dhënat kadastrale	Përshkrimi	Destinimi	Data e publikimit	Afati kohor
1	Parcela nr.1355-1 ZK Llapllasellë	Pjesa e parcelës nr.1355-1 ZK Llapllasellë, sipas PZhK-së të vlefshëm për periudhën 2014-2029. është paraparë	Ndërtimi i stacionit të zjarrfikësve	Gjatë vitit 2024	Shfrytëzim afatgjatë

		për ndërtimin e objekteve publike			
2	Parcela nr.17-8 ZK Graçanicë	Pjesë e parcelës kadastrale nr.17-8 ZK Graçanicë	Ndërtimi i impiantit për prodhimin e energjisë elektrike nga energjia diellore	Gjatë vitit 2024	Shfrytëzim afatgjatë
3	Parcela nr.1006-1 dhe 1006-3 ZK Gushterica e Poshtme	Parcelat ndodhen në zonën e biznesit, e cila është përcaktuar me PZhK-në ekzistues për periudhën 2014-2029	Ndërtimi i objekteve afariste	Gjatë vitit 2024	Shfrytëzim afatgjatë
4	Parcela nr.305-0 ZK Suhadoll	3 lokale në Suhadoll	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2024	Shfrytëzim afatshkurtër
5	Parcela nr.603-0 ZK Lepinë	2 lokale në Lepinë	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2024	Shfrytëzim afatshkurtër
6	Parcela nr.509-0 ZK Llapllasellë	4 lokale në Llapllasellë	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2024	Shfrytëzim afatshkurtër
7	Parcela nr.1434-2 ZK Graçanicë	Lokalet në QT Graçanicë	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2024	Shfrytëzim deri në 1 vit
8	Parcela nr.516-0 ZK Gushterica e Poshtme	Lokalet në QT Gushterica e Poshtme	Ushtrimi i aktivitetit afarist	Gjatë vitit 2024	Shfrytëzim deri në 1 vit

Asamblisti Nebojsa Markoviq, para partisë "SRPSKA", pyeti se sa është sipërfaqja e parcelave nr.1006-1 dhe nr.1006-3 ZK Gushterica e Poshtme, në listën me nr.3.

Drejtori Trajkoviq u përgjigj se njëra parcelë është 24 ari, ndërsa tjetra është 2 hektarë e 36 ari. Parcelat ndodhen në zonën biznese pranë rrugës Prishtinë-Ferizaj dhe një parcelë është shfrytëzuar nga kompania "Dino". Ministria nuk i ka lejuar ata të vazhdojnë punën, pasi u ka

skaduar kontrata me Komunën e Lipjanit, të cilën e kishin marrë para themelimit të Komunës së Graçanicës.

**Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me votat e 15 asamblistëve “Pro” dhe 3 vota “Abstenim” të Vlladica Gjurçiqit, Stefan Mitroviqit dhe Jellenës Dimitrijeviq, miratoi pikën e shtatë të rendit të ditës.**

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tetë të rendit të ditës:

#### 8. Të ndryshme.

Kryesuesi tha se për mbledhjen e radhës të Kuvendit propozon që të dërgohet kërkesa në ministrinë përkatëse lidhur me mospagesën e mëditjeve për mbledhjet e komiteteve të tjera dhe shpreson që asamblistët do ta mbështesin atë kërkesë. Kjo do të përfshijë OSBE-në, e cila ofroi ndihmë këshilluese për anëtarët e Komitetit për Komunitete, për t'u paguar mëditje për mbledhjet.

Asamblisti Dejan Jeftiq, para partisë “SRPSKA”, e pyeti asamblistin Maksimoviq nëse ishte i njoftuar me kërkesën e Këshillit lokal të Gushtericës së Epërme lidhur me parcelën pas shkollës.

Asamblisti Dragan Maksimoviq, para partisë “SRPSKA”, u përgjigj se parcela është shitur para dy vitesh dhe pronari i ri ka kërkuar që të lejohet të kalojë nëpër oborrin e shkollës për ta shfrytëzuar atë parcelë.

Kryesuesi shpjegoi se nuk ka numër të parcelës në atë kërkesë, por vetëm është cekur se gjendet prapa shkollës, kështu që fillimisht duhet parë numri i parcelës dhe më pas do të dërgohet kërkesa në Kabinetin e kryetares për të parë se çfarë mund të bëhet në lidhje me të.

Asamblisti Ljubisha Karaxhiq, para partisë “SRPSKA”, u shpreh i pakënaqur që të gjithë drejtorët, përveç drejtorit të Shërbimeve Publike, i cili është i pranishëm, nuk qëndruan deri në fund të mbledhjes, sepse në pikën “Të ndryshme” kishte një pyetje për drejtorin e NPK “Ekologjia”, përkatësisht pse rrugët nuk pastrohen edhe në vende të tjera dhe si pritet stina e dimrit me infrastrukturë të keqe rrugore.

Asamblisti Nebojsa Markoviq, para partisë “SRPSKA”, sugjeroi që dy ditë para mbledhjes së Kuvendit të kenë një kolegjum, siç bënin në periudhën e mëparshme.

Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 12:03.

Procesmbajtësi

Agron Karadollami



Kryesuesi i KK të Graçanicës

Milan Dimitrijević